



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN  
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. Q-13009/prot.

Tiranë, më 01 / 07 / 2021

Lënda: Kthim përgjigje

QENDRËS "RES PUBLICA"

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", pranë Bashkisë Tiranë është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-13009, datë 15.06.2021 dhe ka kaluar për shqyrtim në Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, e cila nëpërmjet Drejtorisë së Transportit dhe Trafikut Rrugor, ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. Q-13009/1, datë 28.06.2021 si më poshtë:

"Në përgjigje të kërkesës tuaj, lidhur me vënien në dispozicion të dokumentacioneve dhe informacion mbi transportin urban të Bashkisë Tiranë ju bëjmë me dije se:

1. Kompanitë private që ofrojnë shërbimin e transportit urban në Tiranë janë sipas tabelës më poshtë:

| SHOQERIA      | EMËRTESA LINJËS                                                                     |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| FERLUT SH.A   | Linja nr. 14 "Unaza"                                                                |
| TIRANA LINES  | Linja nr.6 "Laprakë"                                                                |
|               | Linja nr. 5/B "Institut - Qendër"                                                   |
| ALBA TRANS    | Linja nr. 13 "Tirana e re"                                                          |
|               | Linja nr. 5/A "Ish Kombinati I Autotraktorëve - Qendër"                             |
| TIRANA BUS    | Linja nr. 8 "Ish Stacioni I Trenit-Qender-Sauk I Ri/Sauk I Vjeter/Sanatorium - Teg" |
| T.U.TRANS     | Linja nr. 11 "Porcelan"                                                             |
| SHEGA TRANS   | Linja nr.15 "Kombinat-Kinostudio"                                                   |
|               | Linja nr. 7 "Tufina"                                                                |
| MAG UTILITIES | Linja nr. 2 "Teg-Sauk I Vjeter-Kopshti Zoologjik-Ish St.Trenit "                    |
| GERARD - A    | Linja nr. 9 "Qytet Studenti- Jordan Misja"                                          |
|               | 10/A "Marteniteti Iri-Qender-Ish Fusha E Aviacionit " 10/B "Qender – Mihal          |

|                 |                                                                    |
|-----------------|--------------------------------------------------------------------|
|                 | Grameno-Qender'                                                    |
| CITY TRANS -A   | Linja nr. 3 "Kashar "                                              |
| TIRANA TRAVEL   | Linja nr.12/A "Uzina Dinamo E Re-Sharre " Dhe 12/B "5-Maji Sharre" |
| DIAMOND SOCIETY | Linja nr. 1 "Selite-Kristal-Qender-St.Trenit-Allias "              |
| REMI TRANS      | Linja nr. 4 "Qender-Qtu-Megatek-City Park"                         |

2. Për sa i përket kërkesës për vënie në dispozicion të kontratave të shërbimit të secilës linjë qytetëse me Bashkinë Tiranë, ju sqarojmë se të gjitha kontratat e transportit përmbajnë të njëjtat dispozita. Sa më lart, duke qenë se pjesë e kontratave janë edhe të dhëna personale të përfaqësuesëve të kompanive që janë licensuar në linjën përkatëse, po ju përcjellim bashkëlidhur një kontratë tip e cila është njësoj për të gjitha linjat, ku nuk citohen të dhënat personale që mbrohen me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (e ndryshuar).
3. Kompanitë private të licensuara në shërbimin e linjave qytetëse nuk marrin asnjë fond nga buxheti i Bashkisë Tiranë".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt,

**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

  
Blerta Goxha



**BASHKIA E TIRANËS**

**SHOQËRIA " [REDACTED] " sh.a**

## **KONTRATË SHËRBIMI**

**PËR**

**“TRANSPORTIN E UDHËTARËVE NË LINJËN QYTETËSE**

**“ [REDACTED] ”**

**SË BASHKISË SË TIRANËS”**

Tiranë, \_\_\_\_\_

Sot, më datë \_\_\_\_\_ 2021, në Tiranë lidhet kjo kontratë shërbimi ndërmjet:

**BASHKISË SË TIRANËS**, me adresë: "Sheshi Skënderbej", nd. 2, kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Kryetari, Z. Erion Veliaj, në vijim referuar edhe si "Bashkia";

dhe

**SHOQËRISË "\_\_\_\_\_"** sh.a me seli \_\_\_\_\_ në Tiranë dhe numër NUIS \_\_\_\_\_, me Licencë të Bashkisë së Tiranës Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ për linjën \_\_\_\_\_, përfaqësuar ligjërisht nga z. \_\_\_\_\_, Administrator, në vijim i referuar edhe si "Operatori" ose "Operatori i Linjës";

Bashkia dhe Operatori Linjës do të referohen në vijim edhe si "Pala" ose "Palët".

#### **Kushte paraprake**

- A. *Duke marrë në konsideratë* përgjegjësinë funksionale të Bashkisë për zhvillimin e transportit urban qytetës, veçanërisht krijimin e lehtësirave operacionale dhe organizative;
- B. *Duke marrë në konsideratë* përgjegjësinë funksionale të Bashkisë për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët dhe operatorët e transportit;
- C. *Duke synuar* sigurimin e standardeve të harmonizuara në shërbimin e transportit qytetës të udhëtarëve në të gjitha linjat, në respekt të parimeve të konkurrencës së ndershme, transparencës, mosdiskriminimit të udhëtarëve, fleksibilitetit dhe përshtatshmërisë së shërbimit;
- D. *Është e nevojshme* të sigurohet harmonizimi i kushteve teknike në shërbimin e transportit qytetës të udhëtarëve në të gjitha linjat dhe jo vetëm, në mënyrë që të përmirësohet siguria në rrugë dhe mbrojtja e mjedisit;
- E. *Është e nevojshme* që operatorët të angazhohen dhe të jenë pjesë e një pune të bashkërenduar mes ekipeve të transportin qytetës të udhëtarëve;
- F. *Është e nevojshme* që të vendosen modele uniforme dhe të standardizuara të procedurave dhe të shërbimeve, me rregulla të njëjta për operatorët e linjave të transportin qytetës të udhëtarëve me autobus;
- G. *Duke qenë se Operatori i Linjës* është i licencuar nga Bashkia e Tiranës për ofrimin e shërbimit të transportit qytetës të udhëtarëve në linjën "\_\_\_\_\_";
- H. *Duke qenë se Operatori i Linjës* zotëron kapacitetet për të realizuar shërbimin sipas specifikimeve të kësaj kontrate duke garantuar korrektësi, paanësi dhe transparencë gjatë kryerjes së shërbimit, si dhe disponon aftësitë teknike të kërkuara në përputhje me standardet e Bashkisë;

**Palët**, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë bien dakord si më poshtë vijon:

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj kontrate është sigurimi i shërbimit të transportit qytetës të udhëtarëve brenda juridiksionit territorial të Bashkisë së Tiranës nga ana e Operatorit për linjën "██████", duke garantuar korrektësi, paanësi dhe transparencë gjatë kryerjes së shërbimit dhe kushte optimale shërbimi për udhëtarët.

## **Neni 2**

### **Përkufizime**

Për qëllimin dhe objektin e kësaj kontrate, termat e përdorur në vijim kanë këtë kuptim:

1. **"Ambientet e jashtme të transportit publik"** – janë stacionet dhe vendqëndrimet e mjeteve të transportit publik;
2. **"AMK"** - është Agjensia e Mbrojtjes së Konsumatorit e Bashkisë së Tiranës;
3. **"Autobusë/t"** – mjet motorik i prodhuar vetëm për transportin e udhëtarëve me më shumë se 8 vende të ulura, përveç atij të drejtuesit të automjetit. Autobusët duhet të jenë mjete të certifikuara për transport qytetës udhëtarësh në përputhje me kërkesat teknike, të pranimit në tregun e shërbimit;
4. **"Certifikata"** – është dokumenti, që mbahet në mjet për vërtetimin e plotësimit të kushteve teknike të paracaktuara për mjetet e linjës në operim;
5. **"Drejtues i mjetit motorik"** – është çdo shtetas, që ka fituar shkallën e nevojshme të kualifikimit për drejtimin e një mjete motorik (autobus);
6. **"Frekuencë lëvizjeje të mjeteve"** – nënkupton harkun kohor ndërmjet dy mjeteve të njëpasnjëshme, që lëvizin në të njëjtën Linjë;
7. **"Informatizimi i Stacioneve"** – pajisja e stacioneve me informacionin për linjën sipas formatit dhe afateve të plotësimit të miratuara me Urdhër Kryetari;
8. **"Kontrata"** – është kjo kontratë shërbimi;
9. **"Linja"** – është linja qytetëse "██████" dhe intenerari rrugor i miratur me vendim të Këshillit Bashkiak të Tiranës, që ndjekin në mënyrë të detyrueshme mjetet e Operatorit gjatë kryerjes së shërbimit të transportit qytetës të udhëtarëve;
10. **"Licenca"** – është akti administrativ i lëshuar nga Kryetari i Bashkisë me Nr. 12560, datë 24.03.2021 që i njeh Operatorit të drejtën të fillojë e të ushtrojë veprimtarinë e transportit qytetës të udhëtarëve, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Kontratë.
11. **"Mjet" (mjet motorik)** – sipas kësaj kontrate, nënkupton autobusët sipas përkufizimit të pikës 3 më lart;
12. **"OMMST"** – është sektori i Menaxhimit e Monitorimit të Sistemeve të Trafikut pranë Bashkisë së Tiranës;
13. **"Sigurimi i Kontratës"** – është garancia e dhënë nga një shoqëri prestigjioze sigurimesh në favor të Bashkisë me qëllim garantimin e një shërbimi të rregullt e të përpiktë konform stardartëve dhe kushteve teknike të kërkuara, nëse Operatori rezulton në mospërmbushje sikurse janë të përcaktuara në këtë Kontratë dhe në raport me përgjegjësinë profesionale që ka në lidhje me të;

14. **"Sigurimi i detyrueshëm në transportin publik"** – do të thotë sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik dhe sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet e shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti;
15. **"Sistemi i Informimit BUS"** – është sistemi i informimit të udhëtarëve i ndodhur brenda mjeteve të transportit të linjës, sipas formatit të aprovuar;
16. **"Sistemi i informimit"** – janë sistemet e informimit për klientët/ pasagjerët lidhur me intenerarin, stacionin, orarin dhe tërë elementet e tjerë, që mundësojnë funksionimin e shërbimit të transportit qytetës;
17. **"Sistemet GPS/SIT"** – janë sistemet e teknologjisë së lartë të informacionit, që mundësojnë menaxhimin, monitorimin, kontrollin dhe certifikimin e shërbimit të transportit qytetës në mënyrë elektronike;
18. **"Shërbimi i transportit qytetës të udhëtarëve"** – është shërbimi i rregullt i transportit me autobus, që plotëson nevojat e popullsisë, brenda juridiksionit territorial të Bashkisë së Tiranës, duke lidhur qendra të rëndësishme ekonomike dhe sociale me pjesët e tjera të qytetit. Shërbimi kryhet nga kontraktorët/operatorët e licencuar dhe të kontraktuar për linjën/linjat përkatëse, me një frekuencë të specifikuar dhe përgjatë një rruge të përcaktuar, nga ku udhëtarët mund të hipin e të zbesin në stacionet e paracaktuara. Ky shërbim i nënshtrohet detyrimit për të respektuar, inteneraret, oraret dhe tarifat e përcaktuara më parë;
19. **"Stacione"** – janë vendet e paracaktuara dhe miratuara me vendim të Këshillit Bashkiak për qëndrimin e detyrueshëm të mjeteve, me qëllim marrjen ose lënien e udhëtarëve përgjatë të gjithë Linjës.

### Neni 3 Objekti i kontratës

1. Ofrimi i shërbimit të transportit qytetës të udhëtarëve në linjën "██████" nga Operatori, në përputhje me stacionet, frekuencën dhe kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të shërbimit të përcaktuara në:
  - (i) Vendimin e Këshillit Bashkiak, nr. 39, datë 23.05.2016 për *"Përcaktimin e linjave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë e Tiranës, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja"* (i ndryshuar) (në vijim "VKB nr. 39/2016 (i ndryshuar)");
  - (ii) Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 27309 datë 13.09.2016 për *"Kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimit publik të transportit qytetas të udhëtarëve në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak, nr. 39, datë 23.05.2016 për "Përcaktimin e linjave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë e Tiranës, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja"* (i ndryshuar) (në vijim "Urdhëri nr. 27309/2016 (i ndryshuar)"); dhe
  - (iii) Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 30808, datë 24.08.2017 për *"Kushtet e posaçme të shërbimit në Linjën "██████" (në vijim "Urdhëri nr. 30808/2017")*; bashkëlidhur kësaj Kontrate si Aneksi nr. 1 (në vijim referuar së bashku si *"Standartet dhe Kushtet Teknike të Shërbimit"*).
2. Operatori ofron shërbimin e transportit qytetës kundrejt një tarife e cila përcaktohet nga Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 66, datë 30.12.2015 për *"Indeksimin e tarifave të transportit qytetës në Bashkinë e Tiranës"*.

3. Operatori pranon dhe deklaron se shërbimi objekt i kësaj Kontrate është shërbim publik dhe si i tillë nuk mund të pezullohet apo braktiset në asnjë rast, me përjashtim eventeve të forcës madhore apo grevave, ku për këto të fundit duhet gjithësesi të garantohet shërbimi minimal. Gjithashtu, nëse është e pamundur të ofrohet me rregullësi dhe qëndrueshmëri shërbimi për shkak të eventeve të forcës madhore të cilat bëjnë të pamundur ofrimin e shërbimit, ky i fundit mund të pezullohet përkohësisht deri në rivendosjen dhe normalizimin e qarkullimit rrugor.

#### **Neni 4** **Baza ligjore**

Kjo kontratë bazohet në nenin 9, pika 1.6, shkronja "a" dhe nenin 64, shkronjat "a" dhe "gj", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar; ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar; ligjin nr. 7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidëve të punës", i ndryshuar; ligjin nr. 8626, datë 22.06.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i ndryshuar; ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996, "Për statusin e të verbërit", i ndryshuar; vendimit nr. 277, datë 18.6.1997, të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i të verbërit", i ndryshuar; vendimit nr. 325, datë 19.03.2008, të Këshillit të Ministrave "Mbi rregullat për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor, të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe njohja e dokumenteve zyrtare, të caktuar për këta operatorë", i ndryshuar; vendimit nr. 1243, datë 10.09.2008, të Këshillit të Ministrave "Mbi miratimin e rregullores për organizimin e kohës së punës të personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit"; vendimit nr. 13, datë 15.01.2010, të Këshillit Bashkiak "Për vendosjen e gjobave në vend ndaj subjekteve, për shkeljet e kryera në fushën e transportit rrugor"; vendimit nr. 66, datë 30.12.2015, të Këshillit Bashkiak "Për indeksimin e tarifave të transportit qytetës në Bashkinë e Tiranës"; vendimin nr. 39, datë 23.05.2016, të Këshillit Bashkiak "Për përcaktimin e linjave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë e Tiranës, mënyrën e organizimit të shërbimit dhe përcaktimin e stacioneve të qëndrimit të autobusëve të shërbimit në këto linja", i ndryshuar; udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, të ministrit të Punëve Publike të Transportit dhe Telekomunikacionit "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar; udhëzimin nr. 1649, datë 16.08.1999, të ministrit të Punëve Publike të Transportit dhe Telekomunikacionit "Mbi plotësimin e kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve", i ndryshuar; udhëzimin nr. 1, datë 28.1.2009, të ministrit të Punëve Publike të Transportit dhe Telekomunikacionit "Për pajisjen me certifikatën e kompetencës profesionale të drejtuesit të veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor", i ndryshuar; urdhëresën nr. 27458, datë 13.09.2016, të kryetarit të Bashkisë "Për monitorimin, inspektimin, raportimin dhe vlerësimin e performancës në shërbimin publik të transportit qytetës të udhëtarëve dhe zbatimin e masave për shkeljet e kontratës të transportit qytetës", të ndryshuar; urdhëresën nr. 27514 datë 13.09.2016, të Kryetarit të Bashkisë "Për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së operatorëve për linjat e transportit qytetas të udhëtarëve, si dhe rinovimin e licencave për këto linja", i ndryshuar; si dhe aktet të tjera të nxjerra nga kryetari i Bashkisë së Tiranës.

#### **Neni 5**

## Afati i kontratës

Në përputhje me kohëzgjatjen e Licencës, kjo Kontratë është e vlefshme sipas afatit të vlefshmërisë së licensës Nr. [REDACTED], datë [REDACTED].

### Neni 6

#### Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë

Pa cënuar të drejtat dhe detyrimet e tjera që burojnë nga kjo Kontratë, Bashkia:

1. harton politikat për transportin dhe trafikun në Bashkinë e Tiranës që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me shërbimin e transportit qytetës të udhëtarëve;
2. përcakton standardet dhe kriteret e nevojshme të organizimit dhe kryerjes së shërbimit të transportit qytetës të udhëtarëve;
3. përcakton përmbajtjen e informacionit për publikun, mënyrat dhe vendet e publikimit;
4. autorizon Operatorin e Linjës, që në rastet e forcës madhore, të ushtrojë veprimtarinë e transportit jashtë linjave të miratuara, për të realizuar plotësimin e nevojave normale të transportit qytetës të udhëtarëve;
5. në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, miraton referencat e sistemit GPS/SIT, për sistemin qendror të menaxhimit, të monitorimi, të kontrollit, dhe certifikimit të shërbimit, i cili duhet të ketë kushtet optimale në shërbim të transportit publik. Për garantimin e standardeve të këtij shërbimi, Bashkia e Tiranës merr përsipër realizimin e këtij projekti në bashkëpunim me operatorët e transportit qytetës të udhëtarëve, kushtet dhe afatet e të cilit do të jenë objekt i një kontrate të veçantë me Operatorin e Linjës;
6. miraton rregulloren e udhëtimit të Linjës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e projekt – rregullores së udhëtimit nga Operatori. Me kalimin e këtij afati drafti do të quhet i miratuar në heshtje;
7. monitoron, inspekton dhe certifikon shërbimin e kryer nga Operatori në përputhje me Urdhresën nr. 27458, datë 13.09.2016 për "Monitorimin, inspektimin, raportimin dhe vlerësimin e performancës në shërbimin publik të transportit qytetas të udhëtarëve dhe zbatimin e masave për shkeljet e kontratës të transportit qytetës (me ndryshime)" (në vijim "Urdhëresa nr.27458/2016"(me ndryshime);
8. modifikon linjat e shërbimit me vendim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave;
9. rivlerëson parametrat teknike, në bazë të legjislacionit në fuqi;
10. monitoron nëpërmjet aksesimit në kohë reale, në ëeb base funksionimin e sistemit GPS ose SIT dhe kontrollon nëpërmjet këtyre sistemeve, elementët teknologjikë, për të mundësuar ndër të tjerash certifikimin e:
  - a. Numrit të mejeve në shërbim
  - b. Shpejtësinë e lëvizjes
  - c. Vendodhjen
  - d. Kilometrat e përshkruara.
11. përmirëson në mënyrë të vazhdueshme parametrat e infrastrukturës rrugore dhe sistemeve të teknologjisë së lartë që garantojnë përparësinë e sistemit BUS;
12. plotëson në mënyrë të vazhdueshme kushtet e infrastrukturës ndihmëse rrugore në stacionet e qëndrimit të mjeteve, me qëllim garantimin e sigurisë rrugore në to;
13. angazhohet në bashkëpunim me Operatorin, të kërkojë dhe ndjekë pranë autoriteteve përkatëse, hartimin dhe miratimin e akteve ligjore/nënligjore në fushën fiskale, mbrojtjes së veprimtarisë së operatorëve dhe pronës së tyre, duke përfshirë edhe elemente të lehtësimit

- fiskal siç janë: akciza e karburantit, kreditimi i T.V.Sh. – së, lehtësimi i taksave vendore dhe shtyrja e afateve të taksave të importit për mjetet dhe pajisjet;
14. angazhohet të propozojë dhe/ose tëndjekë pranë organeve kompetente ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore lidhur me sistemin elektronik të biletimit në transportin publik qytetës.

#### Neni 7

#### Të drejtat dhe detyrimet e Operatorit të Linjës

Pa cënuar të drejtat dhe detyrimet e tjera që burojnë nga kjo Kontratë, Operatori i Linjës:

1. kryen shërbimin e transportit qytetës të udhëtarëve në linjën "██████" sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate në zbatim të akteve ligjore në fuqi, akteve të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore edhe ndryshimeve përkatëse që ato mund të pësojnë në vijim;
2. bën informatizimin e stacioneve duke vendosur në të gjitha stacionet e autobusëve informacionet e duhura për udhëtarët, brenda formatit standard dhe afatit të miratuar me Urdhër Kryetari, duke përfshirë rrjetin e linjave në tërësi, linjat që kalojnë në këtë stacion (harta e linjave me të cilën lidhet ky stacion dhe harta e rrjetit të linjave të qytetit) dhe oraret e shërbimit;
3. pajis mjediset e brendshme të mjeteve me informacionin mbi itenerarin e linjës, brenda afatit dhe sipas formatit të miratuar nga dispozitat ligjore në fuqi;
4. 100 % e mjeteve në Linjë duhet të jenë të pajisur me sistemin GPS. Sistemi GPS duhet minimalisht të përmbajë:
  - a. sistemi GPS duhet të jetë i unifikuar për të gjithë operatorët me të njëjtat opsione dhe konfigurim;
  - b. linja të jetë e konfiguruar me emërtesën, numrin dhe itenerarin sipas vendimit përkatës të Bashkisë;
  - c. çdo mjet të ketë kodin e tij unik;
  - d. të jap vendodhjen e gjeoreferencuar të mjetit;
  - e. mjetit të jap një sinjal të caktuar kur është në shërbim, që nënkupton njoftim në momentin e hyrje daljes në shërbim për përshkrimin e itenerarit të linjës kjo shoqëruar dhe me orën përkatëse;
  - f. raportimin në kohë reale të shpejtësisë me të cilën lëviz mjetit si dhe të mundësojë raportim me orar të caktuar të shpejtësisë mestare;
  - g. raportimin e km të përshkuara gjatë kryerjes së shërbimit në kohë reale;
  - h. raportimin e numrit të mjeteve në shërbim;
  - i. kohën e qëndrimit bus/stacion;
  - j. sistemi duhet të jetë i aksesueshëm në çdo moment nga desktop/operatorët që janë pjesë përbërëse e strukturave të monitorimit dhe kontrollit në Bashki.
5. lejon QMMST, AMK, si dhe strukturat e tjera monitoruese/përgjegjëse për transportin në Bashki, të aksesojnë software-in qendror që menaxhon operimin nëpërmjet sistemit GPS;
6. mirëmban sistemin GPS dhe garanton vijueshmërinë e tij;
7. bashkëpunon me Bashkinë për realizimin e sistemeve GPS ose SIT. Financo sistemet GPS, për sa i përket pajisjeve brenda mjeteve, në stacionet e linjës dhe në sallën e kontrollit të lëvizjes dhe krijon mundësinë e lidhjes dhe aksesimit të sistemeve GPS nga strukturat bashkiake përgjegjëse për monitorimin. Garanton financiarisht funksionalitetin e sistemit GPS. Në rastet e implementimit të sistemeve SIT, përcaktimi i kushteve dhe afateve të bashkëpunimit ose të bashkëfinancimit nëse do të jetë e nevojshme do të jenë objekt i një kontrate të veçantë e detyrueshme për Palët për efekt të vlefshmërisë së kësaj Kontrate;

8. drafton dhe propozon rregulloren e brendshme të udhëtimit për Linjën dhe ia paraqet për miratim Bashkisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kësaj kontrate. Me mbarimin e këtij afati rregullorja konsiderohet e miratuar në heshtje, nëse Bashkia nuk prononcohet formalisht;
9. raporton për shërbimin e kryer prej tij sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe Urdhëresës nr. 27458/2016 (e ndryshuar);
10. informon publikun nëpërmjet medias vizive dhe asaj të shkruar për rastet e ndryshimeve në intenerare në raste festash ose devijim e përkohshëm të intenerarit, sipas mënyrave dhe përmbajtjes së miratuar nga Bashkia dhe mbulon shpenzimet përkatësisht;
11. në rastet e forcës madhore dhe sipas kërkesës/autorizimit të Bashkisë kryen shërbimin e transportit qytetës të udhëtarëve jashtë linjave të miratuara dhe informon publikun për sa më sipër;
12. siguron dhe garanton shërbimin minimal të transportit qytetës të udhëtarëve në raste grevash, në përputhje me udhëzimet e Bashkisë dhe Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë";
13. garanton numrin e nevojshëm të drejtuesve të mjeteve për të operuar Linjën, si dhe orarin e punës së drejtuesit të mjetit, sipas përcaktimeve të dhe Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në fuqi;
14. gëzon të drejtën e pajisjes me "Çertifikatën e Vlerësimit të Performancës së Operatorit në Linjë" në përputhje me Urdhëresën nr. 27458/2016 (e ndryshuar);
15. respekton të gjitha detyrimet, si dhe përfiton të gjitha të drejtat, e përcaktuara në aktet përkatëse të miratuara nga organet kompetente.

#### **Neni 8** **Sistemet GPS ose SIT**

1. Përdorimi i sistemeve GPS ose SIT në shërbimin e transportit qytetës të udhëtarëve synon përmirësimin e kapacitetit menaxhues të transportit publik. .
2. Sistemi GPS mundëson përcaktimin e: (a) përshkrimit të itinerarit; (b) orarit të shërbimit (c) numrit të mjeteve në shërbim, (d) shpejtësinë e lëvizjes, (e) vendodhjen dhe (f) km e përshkruara.
3. Sistemi SIT është sistem i aksesimit dhe komunikimit në kohë reale të lidhjes së mjetit me QMMST. Ky sistem ndër të tjerash përveç lidhjes në kohë reale me mjetin e transportit publik, bën edhe njoftimin e udhëtarëve nëpërmjet pajisjeve LED për stacionin e radhës, kohën e mbetur për mbërritjen në stacionin pasardhës, vendosjen e pajisjeve Led në pjesët e jashtëme të stacioneve të linjës, të cilat do të njoftojnë udhëtarët, sistemet e kamerave, sistemet e numërimit të pasagjereve, raportimit, certifikimit, integrimin me sistemin UTC (semafore), etj.

#### **Neni 9** **Intenerari**

Operatori i Linjës merr përsipër të respektojë me rreptësi stacionet e miratuara VKB nr. 39/2016 (i ndryshuar), si dhe intenerarin e lëvizjes së mjeteve për Linjën e operuar prej tij.

#### **Neni 10** **Mjetet**

1. Operatori i Linjës ka detyrimin të ketë në pronësi të vet ose të marrë me qira, të gjitha mjetet e nevojshme për kryerjen e shërbimit, si dhe të zotërojë kapacitetet e nevojshme për mjedis parkimi dhe mirëmbajtjen e mjeteve.
2. Në çdo mjet vendoset detyrimisht emërtimi i Linjës, numri identifikues dhe ngjyra dalluese të miratuara për linjën.
3. Të përdorë mjetet sipas kapacitetit normal mbajtës të përcaktuar në dokumentacionin e mjetit (leje qarkullimi).
4. Operatori i Linjës është i detyruar të përmbushë kërkesat për flotën/inventarin e mjeteve përgjatë zbatimit të kontratës, në zbatim të Urdhrit nr. 30808/2017.
5. Operatori i Linjës është i detyruar që brenda afateve të pasqyruara në Urdhërin nr. 30808/2017 të plotësojë flotën/inventarin e mjeteve në punë, me mjete/pajisje kondicionimi – klime brenda afatit të përcaktuar në këtë urdhër, përveçse kur disponohet ndryshe nga organet kompetente.
6. Mjetet të kenë të instaluar sistemin e njohjes së vendodhjes së mjetit (GPS) brenda afatit të përcaktuar në nenin 7 pika 4 të kontratës.
7. Të zotërojë mjete me pajisje të veçanta për transportin e personave me aftësi të kufizuar (PAK), në zbatim të VKB nr. 39/2016 (i ndryshuar).
8. Përfshimisht gjatë muajit të parë pas pajisjes me licencë dhe nënshkrimit të kësaj kontrate, operatori paraqet grafikun e importit dhe vënies në punë të mjeteve, duke respektuar afatin maksimal të përcaktuar në Urdhërin nr. 30808/2017.

#### **Neni 11**

##### **Shtimi i numrit të mjeteve**

1. Operatori i Linjës mund të rrisë numrin e mjeteve mbi atë të parashikuar, duke marrë miratimin e Bashkisë.
2. Bashkia mund t'i kërkojë Operatorit të Linjës, me kërkesë të shkruar, rritjen e numrit të mjeteve për shkaqe të arsyeshme, si:
  - a. ndryshimi i gjendjes së trafikut në qytet;
  - b. ndryshimi i numrit të udhëtarëve dhe frekuencës së lëvizjes;
  - c. rritja e cilësisë dhe standardeve të udhëtimit;
  - d. ndryshimi i standardeve minimale të detyrueshme të Linjës;
  - e. Zgjatjen e itinerarit të linjës të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak.

#### **Neni 12**

##### **Orari i fillimit/mbarimit**

1. Shërbimi i transportit në linjë do jetë, për periudhën Prill – Tetor, çdo ditë në orën 05.<sup>00</sup> deri në orën 24.<sup>00</sup> dhe për periudhën Nëntor – Mars fillon çdo ditë në orën 05.<sup>30</sup> deri në orën 23.<sup>30</sup>.
2. Operatori i Linjës do të ofrojë shërbimin e transportit publik qytetës në linjën e miratuar edhe jashtë orarit të detyrueshëm të linjës sipas pikës 1, në varësi të nevojave ose në zbatim të një akti të shkruar nga organet e pushtetit vendor.
3. Stacioni i fillimit/mbarimit të shërbimit në linjën "Tufina" do të jetë sipas urdhërit 30808/2017.

#### **Neni 13**

## **Frekuenca**

Numri i mjeteve në punë sipas intenerarit në linjën "██████" do të realizohet sipas frekuencës së përcaktuar në Urdhërin nr. 30808/2017 .

## **Neni 14 Investimet**

Operatori i Linjës është i detyruar, që brenda afateve të përcaktuara në Urdhërin nr. 30808/2017 të kryejë të gjitha investimet për përmbushjen e Standardeve dhe Kushteve Teknike të Shërbimit të transportit qytetës të udhëtarëve.

## **Neni 15 Ndalimi i Nënkontraktimi**

Operatorit të Linjës për kryerjen e veprimtarisë për të cilën është licencuar nuk i lejohet të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me një subjekt të tretë.

## **Neni 16 Informimi i publikut**

Operatori i Linjës, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, është i detyruar të shqyrtoj ankesat – kërkesat e publikut lidhur me shërbimin, si dhe të informojë publikun mbi shërbimin në linjë, në zbatim të akteve të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore.

## **Neni 17 Informimi i strukturave bashkiake**

Operatori i Linjës, me nënshkrimin e kësaj Kontrate, është i detyruar të informojë Drejtorinë e Transportit dhe Trafikut Rrugor:

- a. një herë në muaj për ecurinë e mbarëvajtjes së shërbimit të transportit publik qytetës në Linjë;
- b. një herë në muaj zërat ekonomikë të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas formatit të kërkuar;
- c. një herë në vit mbi xhiron vjetore, bilancin financiar, vlerën e investimeve dhe riinvestimeve të kryera dhe planifikimit financiar të investimeve që do të kryhet në të ardhmen.

## **Neni 18 Sjellja e personelit të automjetit**

Personeli i automjetit mund të jetë çdo person i punësuar me kontratë pune të lidhur me shkrim me Operatorin e Linjës sipas Kodit të Punës. Gjatë kryerjes së shërbimit personeli i automjetit është i detyruar të zbatojë më përpikmëri të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë Kontratë dhe në aktet e nxjerra nga organet e pushtetit vendor.

## **Neni 19 Llojet e sigurimeve**

Për sigurimin e shërbimit, të mjeteve dhe udhëtarëve, do të aplikohen këto lloj sigurimesh:

- a. Sigurimi i detyrueshëm i mbajtësit të mjetit motorik autobus për përgjegjësinë civile ndaj palëve të treta (TPL);
- b. Sigurimi i pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik;
- c. Sigurimi i kontratës së shërbimit.

## **Neni 20**

### **Sigurimi i mjeteve ndaj palëve të treta dhe pasagjerëve nga aksidentet**

Sigurimi i detyrueshëm i mbajtësit të mjetit motorik autobus për përgjegjësinë civile ndaj palëve të treta (TPL), përfshin mbulimin e shpenzimeve si pasojë e dëmeve materiale, shëndetësore dhe pasurore të shkaktuara ndaj palëve të treta, për shkak të qarkullimit të mjetit motorik të siguruar. Sigurimin e pasagjerëve nga aksidentet në transportin publik, operatori e garanton sipas ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

## **Neni 21**

### **Sigurimi i kontratës**

1. Sigurimi i kontratës së shërbimit (performancës së shërbimit), shërben për të garantuar, zbatimin në mënyrën e duhur dhe brenda afatit të parashikuar të detyrimeve të Operatorit të Linjës në zbatim të kësaj Kontrate dhe akteve të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore.
2. Vlera financiare e kësaj Kontrate për efekt sigurimi, do të jetë në masën prej 15 % të vlerës totale të qarkullimit vjetor të shoqërisë në këtë linjë, sipas bilancit të paraqitur pranë organeve tatimore, në rastet kur aktiviteti i Operatorit përfshin vetëm transportin në linjë. Në rastet e një aktiviteti të përbërë jo vetëm nga transporti qytetës i udhëtarëve, Operatori do t'i provojë shoqërisë së sigurimit me dokumenta të njafueshme zyrtare nivelin që zë vlera e qarkullimit vjetor të linjës përkundrejt qarkullimit vjetor nga aktivitete të tjera dhe rezultati financiar i tyre, në bilancin e plotë të shoqërisë (Operatori).
3. Në rastet kur kjo nuk është e mundur të kryhet, atëherë vlera financiare e mbulimit me sigurimin e kontratës për efekt të llogaritjes së këtij sigurimi, do të jetë në masën 10% e të gjithë qarkullimit vjetor të shoqërisë, sipas bilancit të paraqitur pranë organeve tatimore.
4. Në rastin e një shoqërie të sapo krijuar dhe të licencuar për herë të parë, vlera financiare e kësaj Kontrate për efekt sigurimi, do të jetë në masën prej 15 % të vlerës totale të qarkullimit vjetor të shoqërisë në këtë linjë të parashikuar dhe të deklaruar si të tillë nga Operatori i Linjës.
5. Ky sigurim do të jetë mbi baza vjetore. Paraqitja e policës së sigurimit, do të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të sigurimit pararendës, me përjashtim të policës së parë, e cila depozitohet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
6. Përpara lëshimit të policës, Operatori i Linjës detyrohet të sjellë pranë Bashkisë së Tiranës, draftin e policës/kontratës së sigurimit për miratim paraprak nga Sektori i Licencave në Bashkinë e Tiranës. Mosrespektimi i kësaj procedure e bën policën jo të vlefshme. Kur Bashkia e Tiranës nuk e miraton përmbajtjen e saj edhe pas nënshkrimit dhe paraqitjes, Operatori i Linjës detyrohet ta përsërisë sigurimin, pra të bëjë një sigurim të ri, duke respektuar procedurën e miratimit paraprak të përmbajtjes së draft policës.
7. Operatori i Linjës ka të drejtën e shlyerjes së vlerës së siguruar, në rast të kundërt vlerën e siguruar e shlyen garantuesi.
8. Në rast të zgjidhjes së njëanshme të kësaj Kontrate nga ana e Operatorit të Linjës apo në rast të mosshlyerjes së detyrimeve financiare nga Operatori i Linjës, përfshirë këtu dhe kamatëvonesat,

kategori sociale të cilat, sipas legjislacionit në fuqi e përfitojnë udhëtimin me çmim të reduktuar dhe/ose pa pagesë.

4. Me miratimin e akteve ligjore/nënligjore, që do të rregullojnë mënyrën e aplikimit të kompensimit social në fushën e transportit publik qytetas, kategoritë e udhëtarëve që e përfitojnë atë, si dhe masa e përfitimit të tyre, do të fillojë zbatim i këtij kompensimi social në zbatim të këtyre akteve.

#### **Neni 24**

##### **Dokumentacioni**

Operatori i Linjës detyrohet që në secilin mjet në shërbim, të mbajë dokumentacionin e nevojshëm, si:

- a. lejen e qarkullimit;
- b. certifikatën e kontrollit vjetor teknik dhe të gjithë dokumentacionin teknik;
- c. policën e sigurimit TPL;
- d. kopjen e licencës dhe certifikatën origjinale të mjetit për transport urban;
- e. të pajisë automjetin me fletë udhëtimi, çdo 3 (tre) ditë, që firmoset nga kontrollori teknik i Operatorit dhe nga personi përgjegjës për transportin e Linjës;
- f. Grafikon e frekuencave dhe turneve (të nënshkruara dhe vulosura nga drejtuesi ligjor i Operatorit mbi baza ditore, mujore etj.);
- g. të hartojë librin për evidentimin e punës së kryer ditore dhe të japë evidenca periodike mujore, në strukturën përkatëse të transporteve pranë Bashkisë. Ky dokumentacion ruhet sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 25**

**Monitorimi, inspektimi, raportimi, vlerësimi i performancës në operimin e Linjës dhe zbatimi i masave për shkeljet e Kontratës**

Palët bien dakord se monitorimi, inspektimi, raportimi, vlerësimi i performancës në operimin e Linjës, konstatimi i shkeljeve dhe zbatimi i masave do të kryhen duke u bazuar në procedurat e përcaktuara në Urdhëresën nr. 27458/2016 (me ndryshime) bashkëlidhur kësaj Kontrate si Aneksi nr. 2.

#### **Neni 26**

##### **Penalitetet e Kontratës**

1. Palët bien dakord se, përveç shkeljeve dhe masave të përcaktuara në Urdhëresën nr. 27458/2016 (me ndryshime) bashkëlidhur kësaj Kontrate si Aneksi nr. 2, rastet e mëposhtme përbëjnë gjithashtu shkelje të Kontratës dhe në këto raste do të aplikohen penalitetet kontraktore si më poshtë vijon:
  - a. nëse Operatori i Linjës brenda periudhës 30 (tridhjetë) ditore nuk i paraqet për miratim Bashkisë rregulloren e udhëtimit të linjës, të hartuar prej tij do të aplikohet një penalitet i barabartë me 10.000 lekë;
  - b. mosrespektimi i rregullave të udhëtimit të përcaktuara në rregulloren tip të udhëtimit në transportin publik do të aplikohet një penalitet i barabartë me 20.000 lekë, për çdo rast;
  - c. nëse Operatori i Linjës nuk siguron apo garanton shërbimin e transportit sipas kësaj kontrate në rastet e grevave të sindikatave të punonjësve apo në raste të tjera nëse i

kërkohet specifikisht nga Bashkia do të aplikohet një penalitet i barabartë me 40.000 lekë, për çdo rast.

- d. nëse Operatori i Linjës nuk depoziton sigurimin e ri të kontratës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të sigurimit pararendës ose nga data e ekzekutimit do të aplikohet një penalitet i barabartë me 100.000 lekë, për çdo muaj kalendarik vonesë;
- e. nëse Operatori i Linjës nuk bën sigurimin e njetëve apo sigurimin e pasagjerëve dhe palëve të treta do të aplikohet një penalitet i barabartë me 50.000 lekë për çdo mjet.
- f. nëse Kontraktori i përdor automjetet e certifikuar për shërbimin e transportit të udhëtarëve përtej qëllimit të përcaktuar në kontratë do të merret masë me penalizim deri në shumën 20.000 lekë, për çdo rast.

#### **Neni 27**

##### **Afatet e përmbushjes së detyrimeve**

1. Bashkia njofton menjëherë me shkrim Operatorin e Linjës për mospërmbushjen nga ana e këtij të fundit të detyrimeve të Kontratës.
2. Në rast të mospërmbushjes së këtyre detyrimeve, Bashkia vendos masat e përcaktuara në Urdhëresën nr. 27458/2016 (me ndryshime) dhe nenit 33 të kësaj Kontrate dhe shtyn afatet e përmbushjes së këtyre detyrimeve rast pas rasti, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike. Në rast se edhe pas kësaj periudhe detyrimet nuk përmbushen, Bashkia revokon licencën dhe zgjidh në mënyrë të njëanshme Kontratën.
3. Bashkisë i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e vlerës së sanksioneve/penalitetëve nga dita e vendosjes së sanksionit përkatës. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet nga Operatori i Linjës brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e masës, Bashkia ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatëvonesat përkatëse.

#### **Neni 28**

##### **Kamatëvonesa**

1. Nëse Operatori i Linjës nuk paguan penalitetin kontraktor brenda afatit 5 (pesë) ditor nga vendosja e masës, Operatori i Linjës është i detyruar të paguajë kamatëvonesën për çdo ditë vonesë.
2. Kamatëvonesa për penalitetet kontraktore sipas pikës 1 të këtij neni për çdo ditë vonesë është e barabartë me 2 % të vlerës së masës së marrë ndaj Operatorit të Linjës.
3. Llogaritja e kamatëvonesës bëhet për një periudhë maksimale deri në 30 (tridhjetë) ditë kalendarike, më pas përveç shumës totale të detyrimit për t'u shlyer, Operatorit të Linjës do t'i mbahet shuma e palikujduar (përfshirë kamatëvonesat) nga sigurimi i kontratës.

#### **Neni 29**

##### **Përcaktimi i ngjarjeve të forcës madhore**

Për efekt të zbatimit të kësaj Kontrate Forcë madhore do të quhen:

- a. Fatkeqësitë natyrore, që janë përtej kontrollit të arsyeshëm të palës së prekur, të cilat në mënyrë të arsyeshme nuk mund të priteshin që të ndodhnin; kushtet jashtëzakonisht të këqija të motit, rrufetë, tërmetet, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret apo dhe rrëshqitjet e tokës.

1. Pjesë përbërëse dhe e pandarë e kësaj Kontrate është Aneksi nr.1 dhe Aneksi nr. 2 si më sipër cilësuar.
2. Kushtet dhe parametrat teknike, si dhe aktet e miratuara nga organet e qeverisjes vendore në fushën e transportit publik, respektohen detyrimisht për aq sa lidhen me kësaj Kontrate.
3. Kjo Kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.
4. Kjo Kontratë hartohet në 3 (tre) kopje, nga të cilat 1 (një) kopje për Operatorin e Linjës dhe 2 (dy) kopje për Bashkinë e Tiranës.

**PËR BASHKINË E TIRANËS**

**Për Shoqërinë " [REDAKTUAR] " sh.a**

**Erion Veliaj**

**[REDAKTUAR]**

**KRYETAR**

**ADMINISTRATOR**